



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 1572 prot.

Shkodër, më 23.04.2026

V E N D I M

Nr. 135, datë 23.04.2026

"PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT nr.76 Datë 24.02.2026 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË USH-SË PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të Ligjit të AL me nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa ç; Të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 17 pika 6 germa d; Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar, Udhëzimit nr.27 datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IAL" dhe me Vendim të SA-së nr.127 datë 23.04.2026, Bordi i Administrimit,

Vendosi:

1. Miratimin e ndryshimit në vendimin e Bordit të Administrimit nr.76 datë 24.02.2026 "Për miratimin e strukturës organizative të USH-së për vitin 2026" për Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporte, pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, nëpërmjet saktësimit të emërimit të pozicionit nga "Specialist/Laborant", në "Specialist".
2. Ky vendim i përcillet Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka

